

ECTS dhe Procesi i Bolonjës

ECTS është sistem i kredive i përdorur në fushën e Arsimit të Lartë Evropian, i miratuar me Deklaratën e Bolonjës. ECTS është njëra nga pikat kyçe të sistemit të Bolonjës. Shumica e vendeve të Bolonjës e kanë miratuar me ligj ECTS për sistemet e tyre në Arsimin e Lartë.

Ndër objektivat e tjera, qëllimi i Deklaratës - Procesit të Bolonjës, është themelimi i sistemit të kredive si një mjet i përshtatshëm i lëvizjeve të studentit. ECTS kontribuon në disa objektiva të Bolonjës, si:

- Kreditë ECTS është element kyç i Kornizës së Bolonjës për Kualifikime, në pajtim me Kornizën e Kualifikimeve Evropiane për mësim gjatë gjithë jetës (EQF). Sipas Kornizës së Kualifikimeve të Bolonjës, cikli i parë dhe i dytë i studimeve, kanë vlera të caktuara të pikëve kredituese të akumuluar.
- ECTS i ndihmon institucionet për ta implementuar – zbatuar objektivat e sigurimit të cilësisë. Në disa vende, ECTS është kërkesë për akreditimin e programeve në arsimin e lartë.
- Gjithashtu, ECTS gjithnjë e më shumë është duke u përdorur edhe nga institucionet e kontinenteve tjera, kështu që është duke luajtur rol në rritjen dhe përfshirjen globale të procesit të Bolonjës

Historiku i ECTS –së

Bashkëpunimi i suksesshëm si dhe lëvizja e studentëve dhe e mësimdhënësve në arsimin universitar, në të cilin përfshihet edhe puna kërkimore dhe shkencore, shtytet me anë të fytjes së sistemit të ri, i cili bazohet në pikë kredituese.

Pika kredituese është një vegël shumë e thjeshtë me anë të së cilës realizohet lidhja në mes të institucioneve.

Modeli i sistemit të bazuar në kredi është përdorur qysh më 1986, në Universitetin e Harvardit, kur filloj që të përdoret “Sistemi për akumulim të kredive”, ky projekt është emërtuar me shkurtesën CATS (Credit Accumulation and Transfer Scheme).

Në vitin shkollor 1989/1990 është paraqitur një projekt – pilot i organizatës ERASMUS i emërtuar me ECTS (European Credit Transfer System). Në këtë projekt - pilot muarrën pjesë 145 institucione universitare të Evropës në pesë fusha të studimit: Administrim biznesi, Kimi, Histori, Inxhinieri mekanike dhe në Mjekësi.

Në fazat vijuese, skema e pilot ECTS institucionet pjesëmarrëse kanë mundur që të zgjerojnë implementimin edhe në disiplina të tjera, kështu që përdorimi i sistemit ECTS të transferit të kredive është treguar shumë i efektshëm, prandaj deri më 1999 në këtë projekt janë kyçur me vetë - iniciativë 1300 institucione arsimore.

Çfarë ofron ECTS-ja

Sistemi evropian për transfer të kredive - ECTS është projektuar dhe zhvilluar nga Komisioni i Bashkësisë Evropiane, me qëllim të krijimit të një procedure të përbashkët për të garantuar njohje akademike të studimeve përbrenda universiteteve të vendit dhe jashtë vendit.

Principet në të cilat është e Bazuar ECTS

ECTS bazohet në tre principe kryesore:

- Transparenca
- Marrëveshja,
- ECTS kreditë

Kredia – njësia për angazhimin e tërësishëm të studentit


ECTS kreditë paraqesin sasinë e angazhimit të përgjithshëm të studentit për të përfunduar lëndën mësimore të caktuar. Kreditë nuk bazohen vetëm në orë të mësimit/javë, por ato paraqesin të gjitha aktivitetet e studentit si: *ligjëratat, puna praktike, seminarët, puna individuale dhe provimet apo aktivitetet tjera vlerësues.*

ECTS kreditë (pika kredituese)

ECTS kreditë janë vlera numerike (nga 1 deri në 60), të përcaktuara për secilën lëndë mësimore dhe të cilat studenti i arrin pas përfundimit të lëndës mësimore dhe provimit në atë lëndë mësimore.

Në sistemin ECTS, 60 kredi prezantojnë angazhimin e studentit për një vit akademik. Normalisht ndarja bëhet në 30 kredi për semestër.

ECTS kreditë mundësojnë njohjen e pjesës së studimeve me anë të transferit të kredive dhe akumulimin e kredive .



Lëndët , mësimore për të cilat llogariten ECTS –kreditë

ECTS kreditë duhet që të llogariten për të gjitha lëndët mësimore që ofrohen për studim – të obligueshme, zgjedhore apo opcionale.

ECTS – kreditë dhe rëndësia e lëndës mësimore.

Numri i kredive nuk përcakton rëndësinë e lëndës mësimore. Rëndësia e lëndës mësimore në ECTS mund të shihet në paketën informative, ku mund të kuptohen qëllimet dhe objektivat e lëndës. Prandaj, lënda mësimore më e ngushtë profesionale nuk do të thotë se përmban më shumë ECTS kredi se lënda më pak profesionale.

ECTS sistemi i notimit të studentëve

ECTS sistemi garanton njohje akademike të studimeve jashtë, duke ofruar mënyrën për matjen dhe krahasimin e të arriturave të studentit dhe të transferimit të tyre prej një institucion në tjetrin.

Nuk duhet përzier në asnjë mënyrë kreditë me notimin e studentëve!

Kreditë reflektojnë sasinë e punës dhe angazhimit të studentit gjatë semestrit për lëndën e caktuar, kurse nota paraqet njësi e cila reprezenton cilësinë e punës së studentit në atë lëndë.

ECTS shkallët e notimit


Notimi në ECTS bëhet me shkronja A, B, C, D, E, FX dhe F, si në tabelën e mëposhtme.

ECTS Nota	Përkufizimi	Përqindja e studentëve që normalisht e marrin notën	Nota ekuivalente në UGJFA
A	Shkëlqyeshëm – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore	10 %	10
B	Shumë mirë – mbi mesatare standarde, por me disa gabime	25%	9
C	Mirë – rezultatet në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen	30%	8
D	Kënaqshëm – mirë, por me mjaft gabime	25%	7
E	Mjafton – rezultatet plotësojnë kriteret minimale	10 %	6
FX	Dobët – kërkohet edhe pak punë nga studentit për të fituar kreditë		5
F	Dobët – kërkohet shumë punë për të fituar kreditë		5

Institucionet nuk obligohen që të ndërrojnë sistemin e vetë të notimit, por duhen që sa më shumë t'a ekuivalentojnë atë me sistemin e ECTS.

Transferimi i notave

ECTS notim është si ndërmjetës i cili do të mundësojë ekuivalentimin automatik të notave.



Përparësitë e sistemit të kreditimit për studentë

Disa nga përparësitë kryesore për studentë, në sistemin ECTS janë:

- ECTS garanton njohje akademike për studime jashtë vendit.
- ECTS mundëson qasje në kurse (lëndë mësimore) të universitet tjetër, me mundësinë e pjesëmarrjes së plotë në jetën akademike të institucionit mikpritës për një semestër ose më gjatë.
- ECTS mundëson vazhdimin e studentëve jashtë.
- Ndihmon në krijimin e programit të tij të studimit
- Ofron kohëzgjatjen e studimeve sipas dëshirës.
- Ofron qasje korrekte ndaj angazhimit të studentit.

Llogaritja e ECTS-ve

U.G].F.A. në tabelën si më poshtë paraqet një model për llogaritjen e ECTS-ve (European Credit Transfer System), dhe 1 ECTS është ekuivalent me 25 deri 30 orë pune

Vëllimi dhe sasia e nevojshme e punës: Numri i kredive

Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/kons.	1	15	15
Kolokviume	1	5	5
Detyra shtëpie	1	13	13
Koha e studimit vetanak e studentit	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar ne vleresim (teste, provim final)	2	3	6
Projekte etj.	3	1	3
Gjithsejtë ngarkesa			152 orë
			152 ~5 ECTS

Burimi:

- European Communities, ECTS Users' Guide, Luxembourg, 2009
- Dr. Edmond Beqiri, ECTS – Sistemi Evropian për Transfer të Kredive, Pejë, 2002